

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË - KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
Direktoratë për Administratë dhe Personal  
Direkçija za Administracju i Personal  
132 AA. AA. 2010



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË - KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

**RREGULLORE  
PËR RUAJTJEN DHE MBROJTJEN E MJEDISIT**

2010

Në bazë nenit 12.2 shkronja c, 17, shkronja (e, f, p) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 5 pika 3 dhe nenit 6 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, nenit 12.1 pika (d, dh, l) propozon për miratim:

## **RREGULLOREN PËR RUAJTJEN DHE MBROJTJEN E MJEDISIT**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

Qëllim themelor i kësaj rregullore është mbrojtja e mjedisit jetësor ,sigurimin e kushteve higjienike për qytetaret në vendet urbane dhe rurale, shëndetit e qytetarëve, për një pamje më të bukur në vendbanime. Më këtë rregullore përcaktohet obligimi i qytetarëve,banorëve të banesave kolektive,bashkësive lokale,Organeve komunale,Organizatave politike,Organizatave joqeveritare si dhe Ndërmarrjeve për mirëmbajtjen e pastërtisë.

Më këtë Rregullore, rregullohet mbrojtja e mjedisit dhe mirëmbajtja në të gjitha Institucionet Publike :shkollat,kopshtet,oborret e ndërtesave familjare dhe afariste,vendet publike,rrugët,parqet,trotuaret,entet shëndetësore fushat sportive,lumenjtë,përrua si dhe përshkruhen masat për mirëmbajtjen e pastërtisë, pastërtisë në fshatra si dhe gjelbërimin e sipërfaqeve publike.

#### **Definicionet**

##### **Neni 2**

**Mjedis** –nënkuptojmë hapësira qe na rrethon, vlerat natyrore,vlerat e veçanta dhe pasuritë e krijuara me punë në hapësirën ku jetojmë.

**Mirëmbajtje e pastërtisë**–nënkuptojmë pastrimin dhe larjen e sipërfaqeve publike ,me qëllim të largimit të të gjitha llojeve të mbeturinave dhe borës,pastrimi i oborreve,largimi i fekaleve dhe ujërave të zeza,gropave septike si dhe mbeturinave tjera.

**Mbeturina shtëpiake**-konsiderohen mbeturinat nga hapësirat banues dhe afariste si dhe mbeturinat nga oborret rreth këtyre ndërtesave.

**Sipërfaqet publike**-konsiderohen : sipërfaqet e trafikut publik (rrugët e trafikut publik,stacioni i autobusëve,hapësira e pompave të benzinës,hapësirat e parkingut,sipërfaqet e gjelbëruara,sipërfaqet për pushim dhe rekreacion,fushat (terrenet)sportive,tregjet,hapësirat rreth ndërtesave,kinematë dhe sallat tjera që shërbejnë për takimet publike të qytetarëve,varrezat dhe rrugët e varrezave.

**Rregullim të qytetit dhe të zonave rurale**-nënkuptojmë mirëmbajtjen (pastërtinë mundësinë e gjelbërimit dhe mbrojtjen ) të sipërfaqeve publike.

**Hapësira të tjera**-konsiderohen ato hapësira që nuk janë hapësira publike por që shërbejnë për nevoja të ndërmarrjeve,organeve dhe grupeve të qytetarëve etj.

### **II. Mirëmbajtja-pastrimi i sipërfaqeve publike**

#### **Neni 3**

Për mirëmbajtjen e pastërtisë në sipërfaqe publike janë përgjegjës të gjithë shfrytëzuesit apo pronarët (personat juridik dhe fizik ) të objekteve.Të gjithëve atyre të cilët këto objekte u janë dhëne në menaxhim dhe shfrytëzim janë të obliguar ti mirëmbajnë dhe ti shfrytëzojnë në atë mënyrë si është paraparë më këtë rregullore.

Mirëmbajtjen e pastërtisë në sipërfaqe publike e bëjnë organet kompetente komunale me përgjegjësi si në vijim:

- a. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtjes së Mjedisit** –harton rregullore lokale për çështje mjedisore, kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit ,kujdeset për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta, cakton masa për parandalimin e nivelit të zhurmës dhe vibracioneve në nivel lokal, kujdeset për gjendjen e lumenjve, projet etj
- b. Drejtoria për Shërbime Publike**-kujdeset për pastrim dhe mirëmbajtje të parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave, ofrimin e shërbimeve publike lokale si furnizim me ujë, ujësjellësin, mirëmbajtjen e rrugëve lokale, kanalizim ,transportin lokal etj.
- c. Drejtoria për Inspektorat**-inspekton konform ligjeve në fuqi për mjedis përmes inspektorit për mjedis.
- d. Drejtoria për Arsim dhe Kulturë**-kujdeset për mirëmbajtjen hapësirave edukativo-arsimore, terreneve sportive, argëtuese dhe kulturore.
- e. Drejtoria për Shëndetësi**-kujdeset për mirëmbajtjen e hapësirave të objekteve shëndetësore dhe atyre sociale.
- f. Pronarët, shfrytëzuesit, punë kryerësit dhe menaxhuesit** janë përgjegjës për të gjitha sipërfaqet që e zhvillojnë veprimtarin e tyre përkatëse apo i kanë në shfrytëzim.

#### Neni 4

Sipërfaqet publike duhet të pastrohen në atë mënyrë që në to të jetë një pastërti e vezhdueshme. Mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave të gjelbëruara ,pastrimi dhe larja e rrugëve, trotuareve bëhet në bazë të planit të cilin e hanton Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

### III. Pastrimi dhe mbrojtja e sipërfaqeve publike dhe hapësirave tjera

#### Neni 5

Shfrytëzuesit e hapësirave afariste janë të obliguar që ato ti mbajnë të pasterta. Xhamat e dritareve dhe vitrinat e subjekteve afariste duhet të jenë gjithmonë të pastër dhe të rregullta si dhe hapësira për rreth që shërben për shfrytëzim normal të lokalit afarist.

#### Neni 6

Oborret, koridoret dhe podrumet e ndërtesave banesore duhet të jenë në gjendje të rregullt dhe të pastër. Për mirëmbajtjen e këtyre hapësirave kujdesën pronarët respektivisht shfrytëzuesit e tyre (këshilli banesorë).

#### Neni 7

Të gjithë banorët e fshatrave janë të obliguar që të kujdesen për mbajtjen e pastërtisë në vendet publike dhe sipërfaqet e hapura më interes të përgjithshëm. Banorët e këtyre vendbanimeve janë të obliguar ti pastrojnë oborret dhe sipërfaqet para objekteve të tyre.

#### Neni 8

Ndalohe :

8.1. Hudhja e mbeturinave dhe materialeve tjera në shtratin e lumenjve, përroit, rrugëve, kanaleve dhe sipërfaqeve tjera publike.

- 8.2.Derdhja e ujërave të fekaleve dhe ujërat tjera nëpër rrugë,në sipërfaqe publike dhe në prona tjera.
- 8.3.Lëshimi i ujërave dhe fekaleve nga WC-të dhe gropat septike në kopshte,kanale,rrugë apo oborre të fqinjëve.
- 8.4.Hedhja ose shpërndarja e mbeturinave,ujrave të zeza para apo rreth hapësirave banesore si dhe në ndonjë mënyrë tjetër që rrezikojnë kushtet higjienike të banorëve.
- 8.5.Hedhja dhe vendosja e plehut të kafshëve në sipërfaqe jashtë oborreve të tyre,si dhe në pronën e tyre në vendin në të cilin e pengon fqium,gjëgjesisht në distancë të mjaftueshem që nuk e pengon fqium.’
- 8.6.Përdorimi i gropave të braktisura për ti derdhur ujërat e zeza apo për ti deponuar mbeturinat.
- 8.7.Përdorimi i shtëpive të pabanuara për te hudhur mbeturina dhe materiale tjera.
- 8.8.Hedhja e mbeturinave mjeksore ,vajrave motorike dhe derivateve të naftës në të gjitha vendet publike për veq në vendet e caktuara.
- 8.9.Hedhja e mbeturinave ndërtimore në të gjitha vendet publike për veq në vendet të cilat i cakton Drejtorija për Planifikim Urban,Kataster dhe Mbrojtje të Mjedisit.
- 8.10.Hedhja apo groposja e kafshëve ,shpezëve të ngordhura dhe eshtrave të kafshëve jasht vendit të caktuar për këtë qëllim.

#### Neni 9

Hotelet ,mishtoret,blegtoret,fermat e pulave si dhe personat fizik obligohen që eshtrat e kafshëve dhe shpezeve të therura ti vendosin në kontejnerin e caktuar për këtë qëllim. Ndërrmarrja e cila bëne bartjen e ketyre eshtrave është e obliguar që ato ti dërgoj në vendë të caktuar për këte qëllim.

Pronaret e fermave,personat fizik;janë të obliguar qe për kafshët e ngordhura të lajmërojnë ndërrmarrjen përkatëse:në sezonin e veres jo ma larg se 12 orë pas ngordhjes ,kurse në stinen e dimrit jo ma larg se 24 orë për bartjen e tyre në vendin e caktuar.

Lokacion për hedhjen e tyre caktohet nga Drejtoria për Planifikim Urban,Kataster dhe Mbrojtje të Mjedisit.

#### Neni 10

Në kontejnerin për mbeturina shtëpiake dhe në kontejnerin për mbledhje të mbeturinave nga hapësirat publike ndalohet hedhja e mbeturinave industriale dhe veprimtarisë së zejtarëve,orenditë shtëpiake,aparartet sanitare,pjesët e automjeteve,mbeturinat e kopshteve,kafshët e ngordhura,eshtrat,mbeturinat medicinale,derdhja e ujit,vajrave motorike dhe ushqimore si dhe lëngjeve tjera të ngjashme.

#### Neni 11

Mbeturinat të cilat nuk i takojnë mbeturinave shtëpiake,mbahen në vende të caktuar enkas për to deri sa mos të transportohen deri ne deponi.

Ndërrmarrja së cilës i besohen punët është e obliguar në qoftë se kerkohet largimi i mbeturinave të cilat nuk jen mbeturina shtëpiake t ‘i marrë me kompensim të veqantë për hedhjen e tyre në vendin e dedikuar.

#### Neni 12

Ndërrmarrja përkatëse të cilës i janë besuar punët,gjatë bartjes së mbeturinave të kujdeset qe hapësira rreth kontinjerit të mbahet në gjendje të pastër.

### **Neni 13**

Në rrugë dhe në vendet tjera publike, letrat dhe mbeturinat hudhen në shportat e destinuara për këtë qëllim.

Mënyrën ,vendin dhe numrin e kontenjerëve dhe shportave në sipërfaqet publike e cakton Drejtoria për Planifikim Urban, Katastër dhe Mbrojtje të mjedisit në bashkëpunim me Ndërmarrjen kompetente.

### **Neni 14**

Ndërmarrja e cila e bën grumbullimin e mbeturinave është e obliguar që gjatë periudhës së dimrit një herë në tre muaj, pastaj në periudhën e verës një herë në muaj të bëjë dezinfektimin e kontenjerëve për mbeturina dhe të hapësirës rreth tyre.

Njëherë është i obliguar që ta bëjë këtë edhe sipas kërkesës së Zyrtarit për Mbrojtje të Mjedisit dhe Inspektorit të Mjedisit.

### **Neni 15**

Personta juridik apo fizikë dhe firmat të cilët dëshirojnë që në mënyrë të pavarur të bëjnë bartjen e mbeturinave dhe materialeve tjera në deponi janë të obliguar që paraprakisht të marrin pëlqim për këtë nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kataster dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe të paguan kompensimin për hedhjen e mbeturinave në deponi sipas çmimit të përcaktuar nga organi kompetent.

### **Neni 16**

Bartja e mbeturinave nga Ndërmarrja duhet të bëhet me automjetet e mbyllura, në mënyrë që të mos lejohet derdhja e tyre gjatë transportit deri në deponi.

### **Neni 17**

Në sipërfaqe publike ndalohet ndezja e gomave të automjeteve ,ndezja e mbeturinave dhe materialeve të tjera që paraqesin rrezik për shëndetin dhe mjedisin përreth. Ndalohet prerja, copëtimi i druve dhe thëngjillit në trotuare dhe në rrugë publike.

### **Neni 18**

Ndalohet :

- 18.1. Hedhja e gomave në çdo vend,
- 18.2. Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve dhe shportave për mbeturina.
- 18.3. Zhvendosjen e kontejnerëve për mbeturina nga vendet e caktuara pa lejen e Drejtoris për Planifikim Urban, Katastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
- 18.4. Djegjen e mbeturinave në kontejner.

### **Neni 19**

Barjtja e mbeturinave bëhet çdo ditë pune .

## **IV. Pastrimi i borës**

### **Neni 20**

Për pastrimin e borës nga trotuaret dhe para ndërtesave afariste dhe banesore kujdesen personat të cilët i shfrytzojnë këto ndërtesa afariste, ndërsa për pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave familjare dhe para hapësirave afariste (punëtorit, lokalet

afarsite,kiosokat)kujdesen pronaret dhe shfrytzuesit e këtyre ndërtesave dhe hapsirave banesore.

Subjektet e lartpërmendur janë të obliguar që gjatë pastrimit të sipërfaqeve nga alineja 1 ta grumbullojnë borën dhe akullin në skaj të trotuarit,gjëgjesisht në vendin që nuk pengon në qarkullimin e lirë të njerëzve,ndërsa firma kontraktuse për mbajtje të pastërtisë është e obliguar që këtë borë të grumbulluar ta barti menjëhereë jashtë qytezes.

#### **Neni 21**

Pastrimin e borës nga rrugët e qytetit,rrugëve të fshatrave do të bëhet nga firma e cila do të angazhohet për këtë qëllim.

Firma kontraktuse është e obliguar që rrugët e qytezes dhe rrugët që lidhin fshatrat me qytet gjatë reshjve të borës ti mbajnë në gjendje të kalushme për njerëz dhe automjete. Planin për pastrimin e rrugëve nga ky nen do ta bëj Drejtoria e Sherbimeve Publike.

### **V.Pastertia dhe higjena në tregje dhe në objekte tjera**

#### **Neni 22**

Për mbajtjen e pastërtis dhe higjienës në tregje publike dhe private dhe ne objekte tjera kujdesen Ndermarrja publike dhe ato private të cilat menaxhojnë me to .

#### **Neni 23**

Tregjet duhet të mbahen në gjendje të rregullt dhe të pastër.Çdo ditë pune tregjet pas kalimit të orarit të punës duhet të pastrohen mirë,të lahen dhe të jenë ne gjendje te rregullt dhe sipas udhëzimeve standare te bëhet dezinfektimi i tavolinave.

#### **Neni 24**

Tregjet per funksionim normal duhet të ketë:sasi te mjaftueshem te ujit të pishëm,për freskimin e prodhimeve dhe pastrimin e tregjeve,objekte te nevojshme percjellse,nyje sanitare të cilat duhet rregullisht të pastrohen dhe të mirmbahen,te vendosen numer i caktuar i kontejnereve dhe të mirëmbahet.

#### **Neni 25**

Ndalohehet :

- a. Pastrimi i tregut dhe tavolinave te tregut gjatë kohës së afarizmit në treg,
- b. Ndalohehet djegja mbeturinave në treg,
- c. Ndalohehet hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve.

### **VI.Trajtimi dhe menaxhimi i mbeturinave mjeksore**

#### **Neni 26**

Të gjitha entet shëndetsore,shoqërore dhe private janë të obliguar qe të bëjnë klasifikimin dhe trajtimin e mbeturinave mjeksore sipas shkalles së rezikshmëris në menyrr që te mbrohet shëndeti i njeriut dhe te mbrohet mjedisi.

#### **Neni 27**

Për trajtimin e mbeturinave mjeksore kompetent është Qendra Kryesore e Mjeksis Familjare në Fushë-Kosovë.

Të gjitha entet shëndetsore tjera privat në Komun janë të obliguar qe në marrëveshje me QKMF të bëjnë trajtimin e mbeturinave mjeksore.

## VII.Pusetat dhe gropat

### Neni 28

Për një gjendje më të mirë mjedisore, siguri të trafikut dhe kalimtareve duhet që :

- a. Gropat (puset dhe pusetat ) etj në rrugë, sheshe, oborre duhet të jenë të mbyllura.
- b. Pusetat për ujësjellës dhe kanalizim, kablo telefoni dhe kablo elektrike etj të njejta duhet të rregullohen dhe të mbahen në gjendje të rregullt.

Për mirëmbajtjen e gropave (pusetave) nga alinea paraprake pika a) kujdesën pronaret, respektivisht shfrytëzuesit e pasurive të paluajtshme, të cilat u shërbejnë, ndërsa për gropat nga pika b) janë të detyruar të kujdesen Ndermarrjet të cilat i kanë vendosur ato.

## VII.Gjelbërimi dhe parqet publike

### Neni 29

Më qëllim të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelberta dhe të zgjerimit dhe mbjelljes së zonave të reja në tërë territorin e qytezes së Fushë-Kosovës, dhe vendet urbane vihen nën mbikëqyrje dhe mbrojtje në mënyrë të caktuar më këtë rregullore këto sipërfaqe të gjelbëruara:

- a) Parqet, sheshet, rëndet e fidanëve, gjelbërimi i lagjeve banesore, gjelbërimi afër rrugëve të trafikut;
- b) Pjesët mbrojtëse të lagjeve në vendet urbane, para lagjet, vendet e banuara dhe industriale (pjesët mbrojtëse të gjelbërimit, bregut të lumit dhe sipërfaqet tjera ujore)
- c) Sipërfaqet e gjelbëruara të Ndërmarrjeve, organizatave dhe subjekteve tjera;
- d) Sipërfaqet e gjelbëruara me destinim të veçant dhe të dobishme (gjelbërimi rreth varrezave, rreth objekteve kulturore-historike dhe objekte tjera me rëndësi);
- e) Gjelbërimi i vendeve për rekreacion, lokalitetet turistike dhe shëtitorët.

Dispozitat e kësaj Rregullore nuk kanë të bëjnë më pyjet, tokat bujqësore dhe pjesët e natyrës për të cilat zbatohen dispozita tjera ligjore.

### Neni 30

Projektet e të gjitha objekteve të posa ndërtuara në pjesët e gjëra të qytezes në vete duhet të përfshijnë planet dhe skicat e tokës për gjelbërim, të cilat sipas lokacioneve u takojnë atyre objekteve. Projektet të cilat nuk i kanë planet, skicat për gjelbërim do të konsiderohen si jo të plota dhe nuk mund të lejohen.

### Neni 31

Ndalohet :

- a) Krasitja , prerja e drurëve, thyerja e degëve të fidanëve, kositja dhe largimi i barit nëpër sipërfaqet e gjelbëruara pa pëlqimin e Drejtorisë për Shërbime Publike;
- b) Vendosja e lojërave zbavitëse, cirkut dhe rekuizitave , pa pëlqim të Drejtorisë përkatëse;
- c) Rrëhmija për qfarëdo destinimi tjetër pa pëlqimin e Drejtorisë përkatëse;
- d) Largimi , djegia, dëmtimi i shenjave dhe i mbishkrimeve të vendosura më qëllim të mbajtjes së rendit dhe pastërtisë;

- e) Rrëzimi dhe zhvendosja e ulëseve, rekuizitave sportive ,rrethojave te gjëlbrimit etj.

### **VIII.Mbikëqyrja**

#### **Neni 32**

Mbikëqyrjen e zbatimit dhe respektimit të kësaj Rregullore e kryen Drejtoria për Planifikim Urban,Kataster dhe Mbrojtje të Mjedisit,Drejtoria për Sherbime Publike , Drejtoria për Inspektorat ,Drejtoria e Shëndetsis dhe Drejtoria për Arsim dhe Kultur.

### **IX.Gjobat**

#### **Neni 33**

Të gjitha subjektet e lartëpërmendura nëse veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje do të ndëshkohet më këto masa ndëshkuse si ne vijim :

1.Me gjobë prej 50 € do të ndeshkohen të gjithë ata që veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje në vijim:

a) pronaret e lokaleve afariste qe veprojnë në kundërshtim me dispozitat nga neni 6,7,8,15,19 .

b)pronaret dhe shfrytzuesit e banesave kolektive nga neni 5,8,19,

c) banorët e viseve rurale,nga neni 7,8.

d) personat fizikë nga neni 8,15,17.

2.Më gjobë prej 100 € do të ndeshkohen të gjithë ata që veprojnë në kundërshtim më dispozitat e kësaj Rregullorje si në vijim:

a) pronaret e hoteleve,mishtorëve,blegtoret,personat fizikë dhe juridik nga neni 8 alineja 8.8,8.9,8.10-neni 9,10,11,26,27dhe 31.

b) pronaret e lokaleve afariste,hoteliere,industriale,ndërrmarrjet ndërtimore,pompate e karburanteve etj nga neni 16 dhe 28

c)Ndërrmarrjet të cilat menaxhojnë nga neni 20

3.Më gjobë prej 300 € do të ndeshkohen të gjithë ata që veprojnë në kundërshtim më dispozitat e kësaj Rregullorje si në vijim:

a) Ndërrmarrjet përkatëse nga neni 4,12,13,14.

b) menaxheret e tregjeve nga neni 22,23,24,25.

Të gjithë ata të cilët hedhin plehun apo mbeturinat të përcaktuar më nenin 8 pika 8.5 dhe 8.9 do të urdhërohen që këta ta largojnë brenda afatit prej 3 ditësh dhe nëse brenda këtij afati nuk e largojnë do të iu shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej dyfishit të dënimit të përcaktuar më I pika d).

### **X. Dispozitat përfundimtare**

#### **Neni 34**

Nëse subjektet e lartpërmendura nuk e bëjnë pagesen e gjobave të shqiptuara në pajtim më dispozitat e kësaj rregulloreje do të inicohet procedura gjyqësore pranë Gjykatës Komonale për Kundërvajtje.

**Neni 35**

Mjetet e arkëtuara nga shqiptimi i masave ndëshkuese do të derdhen në Buxhetin komunal të cilat dedikohen për ruajtje dhe mbrojtje të mjedisit.

**Neni 36**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal dhe shfuqizon Rregulloren komunale për Rendin Komunal-Mirëmbajtjen, pastrim dhe higjien Publike.

**KUVENDI I KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS**  
**NR. 132 DATË: 11.11.2010**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**JAKUP FËRNAVA**

